

2018


EMBLEMA E KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE



Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë

EMBLEMA

E KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE



Emblemat e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe kanë një kuptim shumë të gjërë.

Përdorimi dhe vëzhgimi i drejtë i emblemeve, përcakton mekanizmat bazë të mbrojtjes humanitare.

Emblemat paraqesin një lidhje të dukshme ndërmjet të drejtës humanitare ndërkombëtare dhe Lëvizjes të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe në nivel ndërkombëtar.

Emblem e Kryqit të kuq është symbol i ndihmës së paanshme e neutrale që u ipet personave të cilët kanë nevojë për ndihmë. Qëllimi është që të mbrohen viktimat dhe ata që u ndihmojnë viktimave.

Përdorimi i emblemes është përcaktuar në bazë të së drejtës humanitare ndërkombëtare. Emblemën e Kryqit të kuq mund ta përdorin vetëm shërbimet mjeksore ushtarake dhe Shoqatat e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.

HISTORIKU

Më 1863, Konferenca Ndërkombëtare miratoi Kryqin e kuq në fushë të bardhë, si shenjë dalluese për shoqatat që u ofronin ndihmë ushtarëve të plagës.

Më 1864 Kryqi i kuq u pranua nga Konferenca diplomatike si shenjë indicative e shërbimeve mjekësore ushtarake dhe u miratua nga e drejta humanitare ndërkombëtare me aprovimin e Konventës së Parë të Gjenevës të vitit 1864.

Më 1876, gjatë të së ashtuquajturës Luftë të Lindjes që tërbonte në Ballkan, Perandoria Osmane vendosi ta përdorte gjysmëhënën e kuqe në fushë të bardhë në vend të Kryqit të kuq, duke deklaruar se kryqi i kuq i fyente ndjenjat e ushtarëve musliman.

Në vitin 1929, Konferenca Diplommatike i pranoi dy emblem tjera si shenja dalluese të njësive dhe të institucioneve mjekësore, edhe atë Gjysmëhënën e kuqe si dhe Luanin e kuq me Diell, të propozuar nga Irani.

Në vitin 1980, Reoublika Islamike e Iranit hoqi dorë nga Luanin e kuq dhe Dielli, duke e zëvendësuar atë me Gjysmëhënën e kuqe.

Aktualisht dy shenja janë në përdorim: Kryqi i kuq dhe Gjysmëhëna e kuqe.



PËRDORIMI I EMBLEMËS

(DIMENSIONI TË MËDHA)

Në kohë lufte:

1. Shoqatat Kombëtare të Kryqit të kuq dhe të Gjysmëhënës së kuqe, janë të pranuar nga qeveritë e tyre dhe kanë të drejtë t'u ndihmojnë shërbimeve mjekësore ushtarake. Ata mund të përdorin emblemin për mbrojtje, por vetëm për personelin dhe pajisjet të cilat u ndihmojnë shërbimeve mjekësore të ushtrisë në kushte lufte.
2. Emblema mund të përdoret për të mbrojtur një spital civil. Në këto raste emblema ka dimensione të mëdha ashtu që të jetë e dukshme nga larg.
3. Shërbimet mjekësore ushtarake mund ta vendosin emblemen me dimensione të mëdha, për qëllime mbrojtëse në kohë lufte.

Në kohë paqe:

1. Përdorimi i dukshëm i emblems për qëllim mbrojtës në automjetin e Komitetit Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq.



PËRDORIMI I EMBLEMËS

PËRDORIMI INDIKATIV (DIMENSIONE TË VOGLA)

Në kohë lufte:

1. Emblema në këtë rast është përdorur për të treguar se ky person është i dërguar nga Levizja e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.

Në kohë paqe:

1. Shoqatat Kombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe janë të autorizuar ta përdorin emblemen në pajtim me ligjet kombëtare dhe në bazë të rregullores së Lëvizjes për përdorimin e emblems të vitit 1991.
2. Shoqatat Kombëtare mund t'i zhvillojnë aktivitetet e tyre duke përdorur emblemen, vetëm me kusht që këto aktivitete të jenë në pajtueshmëri me parimet themelore të Kryqit të kuq dhe të Gjysmëhënës së kuqe.



KEQPËRDORIMI I EMBLEMËS

Keqpërdorimi i emblemës (për qëllime indikative), e devalvon vlerën e emblemës në sy të publikut dhe rrjedhimisht, i'a zvogëlon rolin mbrojtës në kohë lufte.

Keqpërdorimi i emblemës (për qëllime mbrojtëse në kohë lufte) e rrezikon sistemin mbrojtës të rregulluar me të drejtën humanitare kombëtare.

Shtetet nënshkruese të Konventave të Gjenevës janë pajtuar që të ndërrmarin masa ndëshkuese për mbrojtjen dhe ndalimin e keqpërdorimit të emblemës, si në kohë paqe ashtu edhe në kohë lufte.

Cdo përdorim që nuk është i autorizuar nga e drejta humanitare ndërkombëtare, trajtohet si keqpërdorim i emblemës. Ekzistojnë tre tipe të keqpërdorimit të emblemës.



IMITIMI – nënkupton përdorimin e emblemës të ngjajshme që për nga forma dhe/ose ngjyra, mund të shkaktojë konfuzion me emblemën origjinale.

Emblemën nuk mund ta përdorin organizatat ose individët që nuk janë të autorizuar për ta përdorur.

Shpeshherë keqpërdorimi i emblemës paraqitet nga padi-turia. Pasi që të njoftohen ata të cilët e kanë keqpërdorur em-blemën, me rëndësinë e emblemës si system i mbrojtjes humani-tare, ata fillojnë të përdorin shenjë tjetër.

Keqpërdorimi më i rëndë i emblemës bëhet atëherë kur em-blema përdoret për të mbrojtur luftëtarët ose pajisjet ushtarake në kohë lufte.

Keqpërdorimi i rëndë i emblemës që bëhet me paramendim dhe që mund të bëhet shkas për vdekje ose lëndime serioze të tërësisë trupore dhe shëndetit, kualifikohet si krim lufte nga Pro-tokolli I shtesë.

Niveli i sanksioneve që mund të ndërmerren për keqpër-dorimet e emblemës, qartë tregon rëndësinë që bashkësia ndër-kombëtare i ka dhënë respektimit të emblemës. Ky respekt e vë emblemën në rradhë të vlerave bazë, legalisht të mbrojtura në tërë sistemin e së drejtës humanitare



PSE DUHET TË SANKSIONOHEN TË GJITHA KEQPËRDORIMET E EMBLEMËS?

Emblemat e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe janë qendër veprimi e të gjitha aktiviteteve humanitare: emblemat duhet t'i mbrojnë njejtë; viktimat, si dhe ata që ju vijnë në ndihmë viktimave.

Vlera mbrojtëse e emblemës duhet të ndërtohet në kohë paqe, sepse kur armiqësitë do të kenë filluar, mund të jetë vonë për t'i luftuar keqpërdorimet e emblemës.

Duke e parandaluar imitimin dhe uzurpimin e emblemës në kohë paqe, sigurohet që viktimat e konfliktit mos të lihen në mëshirë të fatit dhe që ata që u ndihmojnë atyre, të kenë siguri në punë.

Cdo njëri prej nesh mund ta ruajë dhe ta forcojë vlerën mbrojtëse të emblemës. Ne të gjithë, mbajmë përgjegjësi për ta garantuar mbrojtjen që e mundëson emblema. Ajo nesër mund të na shpëtojë jetën.



KRYQI I KUQ

I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Kur është formuar Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë?

- Kryqi i kuq i Maqedonisë është formuar më 17 mars të vitit 1945 me vendimin e Prezidiumit të lidhjes të ASNOM.

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë është shoqëri nacionale e pavarur prej 21 Maj 1992

Kur Kryqi i kuq i Republikës së Maqedonisë i'u bashkangjit lëvizjes ndërkombëtare?

- Në vitin 1995 Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë u pranua si shoqëri kombëtare e pavarur e Kryqit të Kuq nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të kuq, ndërsa me 27 Nëntor të njejtin vit në Gjenevë në Asamblenë e Përgjithshme të Lëvizjes Ndërkombëtare u bë anëtare e Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe.



Kur u nënshkruan Konventat e Gjenevës nga viti 1949 dhe Protokolet shtesë nga viti 1977 nga ana e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë?

- Qeveria e Republikës së Maqedonisë i ratifikoi dhe nënshkruajti këto dokumente me 25 Gusht të vitit 1993.

Rregulla për mbrojtjen e Emblemës?

- Përdorimi dhe mbrojtja e emblemës të Kryqit të kuq është rregulluar me Ligjin e Kryqit të kuq të Republikës së Maqedonisë, i cili u miratua nga Parlamenti i Republikës së Maqedonisë me 26 Korrik 1994 (Gazeta Zyrtare N.41/9 me 26 Korrik 1994 (Gazeta Zyrtare N.41/94), ku janë parashikuar rregulla për ndërmarrjen e masave për përdorim të drejtë të emblemës të Kryqit të Kuq dhe parandalimin e keqpërdorimit të tij.



KOMITETI NDËRKOMBËTAR I KRYQIT TË KUQ

Komiteti ndërkombëtar i Kryqit të kuq (KNKK) u themelua nga pesë qytetarë zviceranë më 1863 (Anri Dinan, Gijom-Anri Dufor, Gustav Mounii, Lui Apia dhe Teodor Manuar).

Komiteti ndërkombëtar është organizatë humanitare, e pavarur, neutrale dhe e paanshme.

U themelua si rezultat i luftës para më shumë se 130 viteve.

Nuk ka organizatë të ngjajshme si KNKK.

Komiteti ndërkombëtar i'a ka përcjellur autorizimin për mandatin e KNKK. KNKK vepron si ndërmjetësues neutral në mes palëve ndërluftuese.

Si proklamues dhe mbrojtës i të drejtës humanitare ndërkombëtare, përpiqet t'i mbrojë dhe t'u ndihmojë viktimave në konfliktet e armatosura turbullirat dhe tensionet e brendshme të përcjellura me dhunë.

KNKK është aktiv në më shumë se 60 vende të votes dhe ka rreth 9000 anëtare.



ICRC

C'ËSHTË

E DREJTA HUMANITARE NDËRKOMBËTARE?

E drejta humanitare ndërkombëtare, gjithashtu e njohur si ligji i konflikteve të armatosura ose ligji i luftës, është përmbledhje e rregullave, të cilat në kohë lufte i mbrojnë individët që nuk janë ose nuk marrin pjesë më tutje në armiqësi dhe kufizon metodat dhe mjetet ndër-luftuese.

Nxjerrje nga Konventat e Gjenevës:

1. Të plagosurit dhe të sëmurët, pa marrë parasysh cilës pale në konflikt i takojnë, duhet të mblidhen dhe t'u sigurohet kujdesi i duhur. Personeli mjekësor, institucionet mjekësore, mjetet transportuese dhe pajisjet duhet të kursehen. Kryqi i kuq ose Gjysmëhëna e kuq në fushë të bardhë është shenjë që i mbrojnë këta persona dhe objekte dhe si e tillë duhet të respektohet.
2. Pala pjesëmarrëse në luftë që mban nën komandën e saj luftëtarë të zënë rob, është e obliguar që t'i respektojë jetën e tyre, dinjitetin, të drejtat e tyre personale dhe politike, religjioze dhe ideologjike. Ata duhet të mbrohen nga çdo akt dhune ose represioni. Atyre duhet t'u mundësohet korrespondencë me familjet e tyre dhe t'u jepet ndihmë.
3. Palët në konflikt në çdo kohë duhet të bëjnë dallim në mes popullatës civile dhe luftëtarëve me qëllim që të mbrohet popullata civile dhe prona e tyre. Nuk guxon të sulmohet popullata civile, e as personat civil.



PARIMET THEMELORE

PARIMET THEMELORE TË LËVIZJES SË KRYQIT TË KUQ DHE GJYSMËHËNËS SË KUQE

HUMANITETI

Lëvizja Ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe Gjysmëhënës së kuqe e lindur me dëshirë që pa diskriminim t'u jap ndihmë të plagosurve në fushëbetejë duke qenë e paanshme si dhe përpiqet të pengojë dhe zbusë vuajtjet njerëzore në të gjitha rrethanat. Qëllimi i saj është ta mbrojë jetën dhe shëndetin dhe të sigurojë respektimin e personalitetit të njeriut. Kjo e nxit mirëkuptimin reciprok, miqësinë, bashkëpunimin dhe paqen e përhershme midis popujve.

PAANSHMËRIA

Nuk bën kurfarë dallimesh midis popujve, racës, bindjeve fetare, mendimit klasor apo politik. Kjo përpiqet t'i zbusë vuajtjet e individëve, e udhëhequr vetëm me nevojat e tyre, duke u ofruar në rradhë të pare rasteve më urgjente të fatkeqësive

NEUTRALITETI

Për ta ruajtur besimin e të gjithëve, Lëvizja nuk anon nga askush në armiqësi dhe në asnjë moment nuk angazhohet në shqyrtimet e natyrës politike, racore, fetare ose ideologjike.

PAVARËSIA

Lëvizja është e pavarur. Shoqëritë kombëtare, si organe ndihmëse të shërbimeve humanitare të qeverive të veta dhe të nënshtruara ligjeve në shtetet e veta gjithnjë duhet ta ruajnë autonominë e vet, e cila do t'ua bëjë të mundshme që në cdo kohë të veprojnë në pajtim me parimet e Lëvizjes.

VULLNETARIZMI

Kjo është lëvizje vullnetare, në të cilën nuk stimulohet dëshira për arritjen e fitimit.

UNITETI

Në një shtet mund të ekzistojë vetëm një Shoqëri e Kryqit të Kuq ose e Gjysmëhënës së Kuqe. Kjo duhet t'u ofrojë ndihmë të gjithëve dhe të zbatojë veprimtarinë e vet humanitare në tërë territorin

UNIVERSALITETI

Lëvizja Ndërkombëtare e Kryqit të kuq dhe e Gjysmëhënës së kuqe, është universal, në të cilën të gjitha shoqëritë e kanë të njejtin status dhe gëzojnë të drejta dhe detyra të barabarta që reciprocikisht të ndihmohen.

www.redcross.org.mk

